



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCEVE - MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE - MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE  
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO



Përmbushja  
vullnetare e  
obligimeve

Shërbime  
profesionale,  
transparente dhe  
efektive

Zbatim të  
drejtë dhe të  
njëlloshëm të  
ligjeve tatimore

# RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2010

PRISHTINË 2011





## PËRMBAJTJA

<b>1.</b>	<b>FJALA HYRËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM .....</b>	<b>5</b>
1.1.	<i>VIZIONI .....</i>	7
1.2.	<i>MISIONI .....</i>	7
1.3.	<i>VLERAT .....</i>	7
<b>2.</b>	<b>TATIMET .....</b>	<b>8</b>
2.1.	<i>Të hyrat sipas viteve dhe struktura e te hyrave .....</i>	8
2.2.	<i>Të hyrat sipas regjioneve .....</i>	9
2.3.	<i>Kosto e aktiviteteve për njësi .....</i>	10
2.4.	<i>Inkasimi i borxheve dhe detyrimet tatimore te anuluar .....</i>	10
2.5.	<i>Rimbursimet .....</i>	11
2.6.	<i>Rezultatet e kontrolleve dhe aktiviteteve përmbushëse .....</i>	12
2.7.	<i>Pensionet .....</i>	13
2.8.	<i>Lojërat e fatit .....</i>	13
2.9.	<i>Ndjekjet penale dhe ankesat .....</i>	14
2.10.	<i>Auditimi i brendshëm .....</i>	15
<b>3.</b>	<b>PËRKUSHTIMI NDAJ TATIMPAGUESVE .....</b>	<b>16</b>
3.1.	<i>Seminare me tatimpagues .....</i>	16
3.2.	<i>Avokati i tatimpaguesit .....</i>	17
3.3.	<i>Luftimi i korrupsionit .....</i>	17
<b>4.</b>	<b>BURIMET NJERËZORE .....</b>	<b>18</b>
4.1.	<i>Trajnimet .....</i>	18
4.2.	<i>Kodi i etikës dhe mirësjelljes .....</i>	19
<b>5.</b>	<b>BUXHETI DHE PROKURIMI .....</b>	<b>20</b>
<b>6.</b>	<b>RISITE PROGRESIVE GJATE VITIT 2010 .....</b>	<b>21</b>
6.1.	<i>Ndryshimet ligjore .....</i>	21
6.2.	<i>Numrat Fiskal dhe Arkat Fiskale .....</i>	21
6.3.	<i>Teknologjia Informativ .....</i>	22
6.4.	<i>Plani Strategjik 2010 - 2015 .....</i>	23
6.5.	<i>Formimi i Njësive të reja .....</i>	24





## 1. Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm

Viti 2010 ka shënuar përvjetorin e 10<sup>ë</sup> të themelimit të Administratës Tatimore të Kosovës. Ky vit ka qenë një vazhdimësi e punës së stafit të ATK-së duke u pasqyruar me një sukses të vazhdueshëm dhe me sfida e pritje të larta. Edhe gjatë këtij viti, ashtu siç ka ndodhur edhe që nga themelimi i ATK - së janë ndërmarrë hapa të mëdhenj për të përmirësuar dhe ngritur kapacitetet dhe shërbimet tona ndaj publikut e tatimpaguesve në përgjithësi.



Kemi modifikuar e ndryshuar ligjet tatimore të cilët i plotësojnë standardet ndërkombëtare dhe materializojnë parimet e BE-së, kemi draftuar udhëzime administrative për të sqaruar këto ligje, kemi bërë modernizimin e sistemit për përpunimin e të dhënave, është krijuar pozita e Avokatit të Tatimpaguesit - për t'u dhënë hapësirë shqetësimeve dhe çështjeve të cilat tatimpaguesit nuk kanë mundësi t'i zgjedhin nëpërmes kanaleve normale brenda ATK-së; kemi vazhduar bashkëpunimin me Policinë e Kosovës e me Doganat; kemi pasur vizita nga delegacionet e administratave tjera; kemi lancuar linjën e bashkëpunimit pa pagesë me qytetar për lajmërimin rasteve të evazionit tatimor, korrupsionit apo sjelljeve jo të mira nga stafi i ATK-së; kemi vazhduar implementimin e projektit për arkat fiskale; kemi krijuar njësi të reja: ate për menaxhim të riskut dhe njësinë për hetime; kemi draftuar planin strategjik 5 vjeçar - e mbi të gjitha kemi tejkaluar planin e të hyrave duke arritur të mbledhim 221.6 milion Euro.

Kemi bërë të gjitha duke ua bërë kështu tatimpaguesve më të lehtë përbushjen vullnetare dhe që secili të trajtohet në mënyrë të njëtrajtshme, transparente dhe efektive. E gjithë kjo është arritur përmes stafit të ATK-së, për të cilin unë jam shumë mirënjohës.

Ky vit, sikurse edhe vitet e kaluara ka qenë sfiduese, por sfidën më të madhe e kemi përpara. Në vitin 2011 përpjekjet tona do të drejtohen në zgjerimin e bazës tatimore dhe mbledhjen e shumës së duhur të tatimit nga të gjithë tatimpaguesit. Këtë do ta bëjmë përmes rritjes së kapaciteteve tona teknike dhe shtimit të vëllimit të informatave për t'i vënë në dispozicion për ATK-në që të sigurojmë se secili është duke raportuar dhe paguar pjesën e vet të drejtë. Përveç kësaj, do të mundohemi të bëjmë punën tonë me integritet në mënyrë transparente, duke mos lënë dyshime për trajtimin e barabartë të tatimpaguesve ku do ta bëjmë më të lehtë përbushjen duke implementuar deklarin elektronik për të gjithë tatimpaguesit; do të themelojmë një qendër të thirrjeve në të cilën tatimpaguesit mund të bëjnë thirrje falas për të marrë informatat që u duhen lidhur me dorëzimin e deklaratës së tyre dhe obligimet e pagesës.

*Sistemi ynë tatimor do të jetë më i efektshëm kur secili do të jetë pjesë e tij dhe do të kontribuoj me pjesën e vetë të drejtë, prandaj në emër të Administratës Tatimore unë ju falënderoj që paguani tatimet dhe që kontribuoni në zhvillimin ekonomik të vendit tonë!*

Me respekt,

**Behxhet Haliti**  
Drejtor i Përgjithshëm, Administrata Tatimore e Kosovës





### 1.1.VIZIONI ynë është që Administrata Tatimore:

- të formojë dhe të ruaj një imazh pozitiv për të mirën e shtetit të Kosovës,
- të respektohet nga klientët tanë dhe të njihet nga organizatat dhe institucionet ndërkombëtare,
- të përbëhet nga personeli profesionist dhe energjik që do të garantojnë një nivel të lartë të transparencës dhe modernizimin e shërbimeve tona në raport me klientët tanë, përmes të cilës ne do të bëhemi burimi kryesor i të hyrave për shtetin e Kosovën.

### 1.2.MISIONI ynë është:

- të shtohet në maksimum përmbushja vullnetare e obligimeve, duke i dhënë përqendrim të plotë legjislacionit dhe rregulloreve tatimore
- të ofrojmë shërbime profesionale, transparente dhe efektive për komunitetin e tatimpaguesve në mënyrë që ata të kuptojnë obligimet e tyre të pagesës së tatimeve; dhe
- të sigurojmë zbatim të drejtë dhe të njëllojshëm si dhe fuqizimin e ligjeve tatimore me qëllim që të mbliidhen të hyra për buxhetin e Kosovës në një mënyrë efikase dhe me kosto të ultë.

### 1.3.VLERAT TONA

**Administrata Tatimore do të ec përpara falë këtyre vlerave gjatë tërë punës sonë:**


- **Integriteti dhe sinqeriteti** do të jenë gurë themeli i institucionit tonë, që sigurojnë një trajtim të barabartë ndaj tatimpaguesve dhe zbatim të drejtë të ligjeve
- **Profesionalizmi** do të jetë çelësi i suksesit në përmbushjen e misionit tonë, duke synuar në përmirësime të vazhdueshme drejt standardeve më të larta të suksesit
- **Transparenca** do të jetë elementi kyç për ndërtimin e lidhjeve të forta me tatimpaguesit dhe të besimit në Administratën Tatimore
- **Respekti** ndaj tatimpaguesve dëshmohet përmes kontakteve tona në të cilat ne i pranojmë të drejtat e tyre dhe obligimet tona
- **Fleksibiliteti** do të jetë bazë për zhvillimet e reja në organizatën tonë



## 2. Tatimet


### 2.1. Të hyrat sipas viteve dhe struktura e te hyrave

Gjatë vitit 2010 janë realizuar të hyra në vlerë prej 221.6 milion Euro, që në krahasim me të hyrat e planifikuara kemi një rritje prej 5.2 milion € ose 2%, ndërsa në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, të hyrat janë më të larta për 15 milion Euro ose 7%.



Në strukturën e të hyrave sipas llojit të tatimeve, pjesëmarrje më të madhe kanë të hyrat nga TVSH-ja me 51.0%, Tatimi në korporata me 16.4%, Tatimi i mbajtur në Burim me 15.2%, Tatimi për Bizneset Individuale 11.6%, Pasqyra mujore e mbajtjes në burim dhe pagesës së tatimit në interes, dividendë, të drejta pronësore, qira, fitore në lotari dhe lojëra të fatit 5.3%, Tatimi i Paragjykuar 0.2%, Tatimi në Fitim 0.2%.

LLOJ I TATIMIT	PLANI 2010	TE HYRAT E REALIZUARA 2010	STRUKTURA E TE HYRAVE	KRAHASIMI ME PLANIN	TE HYRAT E REALIZUARA 2009	STRUKTURA E TE HYRAVE	KRAHASIMI 2010/2009
0	1	2	3=2/Σ	4=2/1	5	6=5/Σ	7=2/5
TP	2,215,200	443,427	0.2%	20.0%	2,722,463	1%	16%
TF	7,121,612	466,612	0.2%	6.6%	7,731,182	4%	6%
TVSH	93,301,600	113,046,863	51.0%	121.2%	83,198,697	40%	136%
TB	39,534,500	33,710,926	15.2%	85.3%	36,356,966	18%	93%
PD	23,860,700	25,762,265	11.6%	108.0%	24,680,746	12%	104%
WR	7,372,788	11,741,417	5.3%	159.3%	15,715,532	8%	75%
CD	42,943,600	36,414,344	16.4%	84.8%	36,275,987	18%	100%
<b>TOTALI</b>	<b>216,350,000</b>	<b>221,585,852</b>	<b>100%</b>	<b>102%</b>	<b>206,681,573</b>	<b>100%</b>	<b>107%</b>



- TP-** Tatimi i paragjykuar
- TF-** Tatimi në fitim
- TVSH-** Tatimi mbi vlerën e shtuar
- TB-** Tatimi i mbajtur në burim
- PD-** Tatimi për Bizneset individuale
- WR-** Pasqyra mujore e mbajtjes në burim dhe pagesës së tatimit në interes, dividendë, të drejta pronësore, qira, fitore në lotari dhe lojëra të fatit
- CD-** Tatimi për Korporata

Të hyrat e realizuara dhe rimbursimet nga TVSH-ja

(shumat në mil. Euro)

KATEGORIA	2008	2009	2010
1. E HYRA E REALIZUAR NGA TVSH-JA	55.8	83.2	113.0
2. TVSH-JA E RIMBURSUAR	19.9	18.2	20.4
3. E HYRA NETO NGA TVSH-JA (1 MINUS 2)	35.9	65.0	92.6

Rritja e te hyrave ne përgjithësi tregon trend pozitiv te realizimit te hyrave vendore e veçanërisht nga TVSH-ja, ne te cilën ka ndikuar komunikimi me i mire me tatimpagues, zbatimi i obligimit për regjistrimin e stoqeve dhe vërtetimi i TVSH-se së zbritshme ne ato stoqe, trajtimi i mallrave pa origjine si dhe kryerja e transaksioneve bankare mbi 500 €



## 2.2. Të hyrat sipas regjioneve

REGJIONI	PLANI 2010	TE HYRAT E REALIZUARA 2010	STRUKTURA E TE HYRAVE	KRAHASIMI ME PLANIN	TE HYRAT E REALIZUARA 2009	STRUKTURA E TE HYRAVE
0	1	2	3=2/Σ	4=2/1	5	6=5/Σ
FERIZAJ	5,300,000	6,588,288	3%	124%	4,498,441	2%
GJAKOVË	2,950,000	3,532,621	2%	120%	2,993,132	1%
GJILAN	4,500,000	4,776,157	2%	106%	4,325,608	2%
MITROVICË	3,950,000	4,855,389	2%	123%	4,098,645	2%
NJTM	126,250,000	127,112,282	57%	101%	122,271,869	59%
PEJË	7,800,000	7,149,037	3%	92%	6,493,442	3%
PRISHTINË 1	44,700,000	44,629,695	20%	100%	41,517,472	20%
PRISHTINË 2	10,800,000	12,842,952	6%	119%	11,853,073	6%
PRIZREN	10,100,000	10,099,430	5%	100%	8,629,891	4%
<b>TOTALI</b>	<b>216,350,000</b>	<b>221,585,852</b>	<b>100%</b>	<b>102%</b>	<b>206,681,573</b>	<b>100%</b>

Burimi: Teknologji Informative.

## 2.3. Kosto e aktiviteteve për njësi


TË HYRAT (TATIMET DHE KP)	294,676,513
SHPENZIMET E ATK-SË	6,533,986
SHPENZIMET PËR 100€ NE VITIN 2010	2.2
SHPENZIMET PËR 100€ NË VITIN 2009	2.8

## 2.4. Inkasimi i borxheve dhe detyrimet tatimore te anuluar

Mbledhja e Detyrueshme gjatë këtij viti ka inkasuar 43.8 milion Euro, ndërsa për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë inkasuar 40.3 milion Euro qe do të thotë se në këtë periudhë janë inkasuar 9% më shumë ose 3.6 mil.€ Nga thesari gjatë kësaj periudhe nga 339 urdhër-vjelje janë inkasuar gjithsej 2,741,080 euro ( 2,523,467 € në emër të tatimeve dhe 217,612 € në emër të pensioneve), ndërsa borxhet e pasivizuara jënë në vlerë prej 57.5 mil. Euro.

### KRAHASIMI I INKASIMIT TE BORXHEVE

REGJIONI	INKASIMET PËR 2009			INKASIMET 2010			KRAHASIMI ME 2009
	INKASIME TJERA	SIPAS INICIATIVËS	TOTALI	INKASIMET TJERA	SIPAS INICIATIVËS	TOTALI	
0	1	2	3	4	5	6	7=6/3
FERIZAJ	1,325,204	722,588	2,047,791	1,883,791	552,187	2,435,979	119%
GJAKOVA	337,505	453,170	790,675	725,734	276,843	1,002,578	127%
GJILANI	1,191,662	582,559	1,774,221	1,315,639	235,087	1,550,726	87%
MITROVICA	1,045,267	333,819	1,379,086	722,876	253,211	976,087	71%
NJTM	7,888,681	12,383,006	20,271,687	13,085,292	6,182,651	19,267,943	95%
PEJA	1,323,351	1,679,580	3,002,931	1,670,775	366,261	2,037,036	68%
PRISHTINA 1	867,455	4,126,345	4,993,801	10,843,173	881,709	11,724,882	235%
PRISHTINA 2	1,498,249	1,151,709	2,649,958	2,020,933	406,183	2,427,116	92%
PRIZRENI	1,406,975	1,993,306	3,400,281	2,076,637	340,335	2,416,972	71%
<b>TOTALI</b>	<b>16,884,350</b>	<b>23,426,081</b>	<b>40,310,431</b>	<b>34,344,851</b>	<b>9,494,468</b>	<b>43,839,319</b>	<b>109%</b>



## 2.5.Rimbursimet

Rimbursimet, rikthimet dhe kthimet që janë transferuar në xhirollogari të tatimpaguesve për të gjitha llojet e tatimeve për këtë periudhë, janë në vlerë prej 27,596,387, ku prej tyre për rimbursimin, rikthimin dhe kthimin e TVSH-së janë 20,728,304 (75.1%), për TAP (Tatimin e të Ardhurave Personale) janë 852,467 ose (3.1%), për TAK (Tatimi në Korporata) janë 6,015,616 (21.8%). Numri i kërkesave të pranura është 9,313, ndërsa janë shqyrtuar 9,279.

LLOJI I TATIMIT	KËRKESAT		% E TË APROVUARA	SHUMA E APROVUAR	OBLIGIMET NE ATK-Ë	SHUMA E TRANSFERUAR	% E TRANFERUAR
	PRANUARA	APROVUARA					
RIMB. I TVSH-SË	159	130	1.40%	22,002,373	1,578,779	20,423,594	74.0%
KTHIMI I TVSH-SË	24	20	0.22%	365,206	60,497	304,709	1.1%
RIKTHIMI I TVSH-SË	2	1	0.01%	1,559	1,589	-	0.0%
RIMB. TAP	9,120	9,120	98.29%	861,217	8,750	852,467	3.1%
RIMB. TAK	8	8	0.09%	6,027,570	11,954	6,015,616	21.8%
<b>TOTALI</b>	<b>9,313</b>	<b>9,279</b>	<b>100%</b>	<b>29,257,925</b>	<b>1,661,568</b>	<b>27,596,387</b>	<b>100%</b>

## Rimbursimet e TVSH-së sipas viteve

(shumat në mil. Euro)

PËRSHKRIMI/VITET	2007	2008	2009	2010
1. NUMRI I KËRKESAVE	133	153	152	159
2. SHUMA E KËRKUAR	15.7	24.9	21.2	22.0
3. SHUMA E RIMBURSUAR	8.4	19.9	18.2	20.4

Shqyrtimi i kërkesave për rimbursim si dhe realizimi i tyre, gjithashtu tregon një trend pozitiv në krahasim me të kaluarën duke shpejtuar trajtimin e tyre me qëllim të realizimit të drejtave të tatimpagueseve.



## 2.6. Rezultatet e kontrolleve dhe aktiviteteve përmbushëse

Tatimi shtesë si rezultat i kryerjes së 1,835 kontrolleve tatimore dhe vlerësimeve nga zyra është 54.6 milion €, ku sipas llojeve të tatimeve pjesëmarrje më të madhe ka; Tatimi në Korporata dhe Tatimi në Fitim (TF-TAK) 21.7 mil. € (39.7%), TVSH-ja me 17.6 milion € (32.3%), Tatimi për Bizneset e mëdha Individuale 8.9 mil. € (16.3%), Kontributet e Pensioneve 2.0 mil. € (3.7%), Tatimin në interes, lojëra te fatit 1.9 mil. € (3.4%), Tatimi për Bizneset e vogla individuale 821,314 € (1.5%), Tatimin në Qira 773,144 € (1.4%), Tatimi në Paga 772,607 (1.4%), dhe Tatimin e Paragjykuar 107,115 (0.2%).

LLOJI I TATIMEVE	TATIMI SHITESË 2009	STRUKTURA 2009 %	TATIMI SHITESË 2010	STRUKTURA 2010 %
0	1	2=1/Σ	3	4=3/Σ
TF-TAK	21,240,708	41.1%	21,693,183	39.7%
TVSH	13,811,567	26.7%	17,648,564	32.3%
BMI	6,362,895	12.3%	8,928,285	16.3%
K. PENSIONALE	3,128,881	6.1%	2,026,892	3.7%
INT. DIV.LOJR.	141,007	0.3%	1,882,692	3.4%
BVI	1,841,706	3.6%	821,314	1.5%
QIRA	2,076,040	4.0%	773,144	1.4%
TATIMI NË PAGA	1,236,401	2.4%	772,607	1.4%
TP	1,823,328	3.5%	107,115	0.2%
<b>TOTALI</b>	<b>51,662,533</b>	<b>100.0%</b>	<b>54,653,795</b>	<b>100.0%</b>

### TATIMI SHITESË SIPAS REGJIONEVE

REGJIONI	2009	PLANI 2010	REALIZIMI 2010	KRAHASIMI	INDEKSI 2010/09	TATIMI SHITESË 2009	TATIMI SHITESË 2010	INDEKSI 2010/09	PLANI I VIZITAVE 2010	VIZITAT E REALIZUARA 2010
0	1	2	3	4=3/2	5=3/1	6	7	8=7/6	9	10
FERIZAJ	232	252	195	77%	84%	2,404,681	2,156,262	90%	7,704	7,337
GJAKOVA	89	129	75	58%	84%	2,454,709	1,592,628	65%	4,014	6,856
GJILANI	369	332	221	67%	60%	1,736,871	1,670,171	96%	10,302	7,339
MITROVICA	283	258	153	59%	54%	2,824,631	1,524,339	54%	8,028	11,508
NJTM	91	156	84	54%	92%	23,666,738	26,338,913	111%	1,820	2,166
PEJA	338	359	333	93%	99%	2,679,849	5,654,433	211%	11,022	13,887
PRISHTINA 1	341	507	255	50%	75%	7,788,927	8,156,723	105%	15,570	17,005
PRISHTINA 2	312	348	171	49%	55%	4,745,113	4,408,870	93%	10,674	9,882
PRIZRENI	386	367	347	95%	90%	2,117,045	3,056,338	144%	11,208	9,258
NJKS			1	0%	0%	1,243,969		0%		499
<b>TOTALI</b>	<b>2,441</b>	<b>2,708</b>	<b>1,835</b>	<b>67.8%</b>	<b>75.2%</b>	<b>51,662,533</b>	<b>54,558,677</b>	<b>106%</b>	<b>80,342</b>	<b>85,737</b>



### AKTIVITETET PËRMBUSHËSE

REGJIONI	PLANI I VIZITAVE	NR. I VIZITAVE	PËRQINDJA	NR. I GJOBAVE	VLERA E GJOBAVE
0	1	2	3=2/1	4	5
FERIZAJ	7,704	7,337	95.2%	370	72,525
GJAKOVA	4,014	6,856	170.8%	309	62,225
GJILANI	10,302	7,339	71.2%	386	84,175
MITROVICA	8,028	11,508	143.3%	364	83,625
NJTM	1,820	2,166	119.0%	78	69,325
PEJA	11,022	13,887	126.0%	638	117,800
PRISHTINA 1	15,570	17,005	109.2%	897	161,175
PRISHTINA 2	10,674	9,882	92.6%	434	107,425
PRIZRENI	11,208	9,258	82.6%	885	199,050
NJKS		499	0.0%	38	7,225
<b>TOTALI</b>	<b>80,342</b>	<b>85,737</b>	<b>106.7%</b>	<b>4,399</b>	<b>964,550</b>

## 2.7.Pensionet

Administrata Tatimore e Kosovës është përgjegjëse për mbledhjen, detyrimin dhe barazimin e kontributeve të kursimeve pensionale, të paguara nga punëtorët dhe punëdhënësit aktual në Trustin e Kurimeve Pensionale të Kosovës.

Aktivitetet që lidhen me kursimin e pensioneve kryhen përmes stafit përgjegjës si: mbledhjen dhe procesimin e deklaratave të pagesave dhe raporteve bankare, barazimin e pagesave, mbledhjen dhe procesimin e raporteve të punëdhënësit, dhe detyrimin e pagesës dhe raportimin e përmbushjes.

ATK është angazhuar në koordinimin e aktiviteteve me përfaqësues të Trustit me qëllim të ngritjes së efikasitetit në zbatimin e procedurave për kontribute pensionale. Bashkëpunimi me trustin është përqendruar në avancimin e programit të Trustit dhe këmbimin e informatave ndërmejet dy institucioneve.

Gjatë vitit 2010 nga kontributet pensionale janë realizuar 94.6 mil €

## 2.8.Lojërat e fatit

Divizioni i Lojërave të Fatit gjatë këtij viti ka ndërmarr aktivitete për licencimin e subjekteve që merren me këtë veprimtari si dhe mbylljen e subjekteve të palicencuara. Nga lojërat e fatit gjatë kësaj periudhe janë inkasuar nga pagesa e taksës për licencim të lojërave të fatit 1,423,500, ndërsa 25,000 € është vlera e gjobave të lëshuara për shkelje të konstatuara. Po ashtu pas shqyrtimit të kërkesave janë lëshuar 9 licenca të reja për këtë veprimtari, ndërsa janë licencuar edhe 113 njësi të reja të cilat funksionojnë në kuadër të subjekteve ekzistuese të licencuara paraprakisht.



**AKTIVITETE E REALIZUARA**

PËRSHKRIMI	2010	2009
VIZITAT VËZHGUERE BRENDA ORARIT	633	315
VIZITAT PËRMBUSHËSE	532	413
TË TJERA	346	125
VIZITAT NË BASHKËPUNIM ME POLICI - DOGANA	95	104
TOTALI I VIZITAVE	1606	957
LËSHIMI I LICENCAVE	9	9
VLERA PËR LICENCË	175,500 €	115,750 €
VAZHDIM I LICENCAVE	31	32
VLERA PËR VAZHDIM LICENCE	133,000 €	73,000 €
ZGJERIM AKTIVITETI	113	114
VLERA PËR ZGJERIM	1,115,000 €	784,750 €
TOTALI I LICENCAVE DHE ZGJERIMEVE	153	155
TOTALI I VLERËS SË PAGESËS	1,423,500 €	973,500 €
TOTALI I VLERËS SË GJOBAVE TË PAGUARA	25,000 €	40,000 €

**2.9. Ndjekjet penale dhe ankesat**

Zyra ligjore gjate Vitit 2010 ka zhvilluar dhe kryer keto aktivitetet:

DOSJET E DORËZUARA NGA ZYRET REGIONALE			VEPRIMET E ZYRËS LIGJORE NDAJ DOSJEVE				PERFAQËSIMI NË SEANCA			AKTVENDIMET E BORDIT TE PAVARUR PER RISHQYRTIME ( BPR )					VEPRIMET E ATK NDAJ AKTVENDIMEVE TE ( BPR )		AKTGJYKIMET				TE NDRYSHME		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
DOSJET E PRANUARA	DOSJET E SHQYRTUARA	DOSJET E PA SHQYRTUIME	KALLËZIMET PENALE	PARASHKRIMI	MINISTRIA E DREJTËSIS	KTHIMI I DOSJESVE NE REGJION	D. EPARTAMENTI I ANKESAVE	BORDI I PRAVARUR PER RISHQYRTIME (BPR)	GJYKATA	APROVUJARA	PJESERISHT	REFUZUARA	RI-SHQYRTIM	HUDHURA	USHTRIMI I PADISË	APROVIMI I AKTVENDIMIT BPR NGA ATK-SË	PROKURORIA PUBLIKE KOMUNALE	GJYKATA KOMUNALE	GJYKATA E QARKUT	GJYKATA SUPREME	PROKURORIA SHTETIT KOSOVËS	INTERPRETIME, KËSHILLA DHE PERGJIGJEJE	PJESËMARRJA NË KOMISIONIN PER SHQYRTIMIN E VENDIMEVE TE DA, SIPAS VENDIMIT TE DREJTORIT TË DT. 09.10.2009
166	163	10	61	37	12	53	135	127	41	8	6	19	19	11	1	12	5	10	5	2	3	26	115

Zyra Ligjore ka pranuar 166 dosje prej te cilave 163 janë shqyrtuar sipas proceduarve ligjore dhe janë ngritur 61 kallëzime penale. Zyra ligjore ka marr pjese ne përfaqësimin e ATK-se ne seanca te organizuara nga institucione tjera për zbatimin e ligjit si dhe ne te gjitha seancat te organizuara nga Departamenti i Ankesave. Si rezultat i shqyrtimit te lendeve ne favor te tatimpaguesve janë aprovuar 8 aktvendime ,19 aktvendime janë te refuzuara, 19 aktvendime janë ne ri-shqyrtim 11 aktvendime janë negative për shkak të skadimit të afatit të ankesës.



Nga gjykata janë pranuar 10 aktgjykime, prej te cilave 3 aktgjykime te hedhura (borxhi është parashkruar), 5 persona janë dënuar, 1 është liruar nga aktakuza dhe 1 është bërë ndryshim i cilësimit te aktakuzës. Gjykata e Qarkut ka pranuar 3 aktgjykime te refuzuara (kjo do te thotë se është refuzuar ankesa e prokurorit apo e tatimpaguesit kundër aktgjykimit te Gjykatës Komunale) 1 është pranuar ankesa, dhe 1 është i dënuar.

Departamenti i Ankesave gjatë vitit 2010 ka pranuar gjithsej 500 ankesa , prej te cilave janë shqyrtuar 548 ankesa ( në kuadër te cilave 86 ankesa janë të bartura nga viti 2009 ). Nga ankesat e shqyrtuara një rast është aprovuar, 49 raste pjesërisht, 213 janë refuzuar, 39 raste skadim afati, 40 raste janë rivendosje. Gjithashtu ne kuadër te totalit te ankesave janë përfshi 163 raste gjoba mandatare, ku prej tyre 37 raste janë zgjedhur pozitive për tatimpaguesit, kurse 126 raste negative, si dhe 43 raste janë te tjera. Gjate këtij viti numri i ankesave te pranuar ishe me i vogël ne krahasim me vitin e kaluar për 11.6 %, ndërsa është rritur numri i ankesave te shqyrtuara për 10.26 %.

ANKESAT E TATIMPAGUESEVE TE PARASHTRUARA NE DEPARTAMENTIN E ANKESAVE			VENDIMET E DEPARTAMENTIT TE ANKESAVE						GJOBAT MANDATORE		TE TJERA
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
ANKESAT E PRANUARA	ANKESAT E SHQYRTUARA	ANKESAT E PA SHQYRTUARA	APROVUAR	PJESËRISHT	REFUZUARA	RIKONTROLL	SKADIM AFATI	RRITJA E TATIMIT	APROVUARA	REFUZUARA	
500	548	34	1	49	213	40	39	0	37	126	43

## 2.10. Auditimi i brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2010 ka përfunduar 9 auditime te rregullta, prej të cilave 5 auditime te rregullta dhe katër me kërkesën e menaxhmentit, po ashtu ka bërë përcjelljen e implementimit te rekomandimeve te dhëna nga Auditori Gjeneral dhe përcjelljen e implementimit te rekomandimeve te dhëna nga NJAB-i për vitin 2009.

Auditimet e kryera janë shqyrtimi i lendeve lidhur me Vendimin e Qeverisë mbi lirimin e ndëshkimeve, auditimi i Njesisë se Kontrollit Special, auditimi i te hyrave nga tatimet ne regionin e Ferizajt, Pejës, Lojërave te fatit, Mitrovicës, Prishtina 2, Prokurimit dhe rimbursimeve. Nga te gjitha auditimet e kryera gjithsej janë dhëne 69 rekomandime, prej te cilave 36 janë realizuar, 33 janë në proces.



### 3. Përkushtimi ndaj tatimpaguesve

Si objektiv kryesor i ATK-se është krijimi i mundësive sa me te mira dhe hartimi i politikave për përmbushjen vullnetare të tatimpaguesve, ofrimin e ndihmës dhe shërbimeve për tatimpagues, organizimi i seminareve dhe trajnimeve me kategori të caktuara të tatimpaguesve si dhe shërbimeve të drejtpërdrejta për tatimpaguesit për implementimin sa me të mirë të legjislacionit tatimor.

#### 3.1.Seminare me tatimpagues

Pas miratimit të tri ligjeve tatimore (TVSH, TAP dhe TAK) dhe udhëzimit administrativ Nr. 16/2009 për zbatimin e ligjit Nr. 03/L-071 për Ndryshimet dhe plotësimet e ligjit 2004/48 për Administratën tatimore dhe procedurat dhe me qëllim të realizimit të kontakteve dhe njoftimeve të tatimpaguesve për efektet juridike të këtyre ligjeve janë realizuar 7 seminare me tatimpagues në të gjitha regjionet. Temë bosht ka qenë Udhëzimi Nr. 16/2009.

Gjithashtu janë realizuar seminare me Odën Ekonomike të Kosovës dhe me SHKÇAK.

Seminari me anëtarët e SHKÇAK ishte katër ditor dhe janë shqyrtuar këto tema :

- Prezantimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2009,
- Përgatitja e deklaratave vjetore për TAP dhe TAK,
- Procedurat e mbledhjes së detyrueshme,
- Shpenzimet e lejueshme dhe Procedurat e kontrollit,
- Procedurat tjera: NF dhe Anulimi i dokumenteve tatimore, NjHT, Ankesat, etj.
- Ligji Nr. 03/L-161 për Tatim në të Ardhurat Personale (*Përmbajtja dhe Risitë në ligjin për TAP*), dhe
- Ligji Nr. 03/L-162 për tatim në të Ardhura të Korporatave (*Përmbajtja dhe Risitë në ligjin për TAK*),
- Kërkesat për libër-mbajtje të Kontratave afatgjate ndërtimore dhe tregtarët e derivateve,
- Ligji Nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (*Përmbajtja dhe Risitë*) me fokus në Nenin 20 "*Vendi i furnizimit të Shërbimit*",
- Procedurat e rimbursimit të TVSH-se, pastaj,

Janë realizuar edhe Seminare tjera në fusha të ndryshme të përbashkëta me Odën Ekonomike të Kosovës, katër seminare për Arka Fiskale, pastaj me Institutin Gjyqësor të Kosovës për Gjykatësit e Gjykatës Supreme dhe prokurorët.



### 3.2. Avokati i tatimpaguesit

Funksioni i Avokatit të tatimpaguesit, si pozite e re në ATK-ë ka filluar të funksionoj nga Janari 2010. Aktivitetet kyçe të kësaj pozite janë shqyrtimi i rasteve të tatimpaguesve që kryesisht kanë kaluar procedurat e ankesave, lëshimet dhe gabime në deklaratimet dhe pagesat e tatimeve, mos marrja në konsideratë e dokumentacionit të tyre për arsye të cilat kanë qenë jashtë rrethanave normale, etj. Nga Avokati i tatimpaguesit janë pranuar 76 ankesa të tatimpagueseve dhe pjesa dërmuese e këtyre rasteve kanë marrë përgjigje me shkrim.

Aktivitete tjera të avokatit gjatë këtij viti ishin pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e UA të Ligjit Nr. 03L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, organizimi i takimeve për shqyrtimin e rasteve me persona kompetent, bashkëpunimi me këshilltarët ndërkombëtar në finalizimin e formës “ Anketat e pëlqimit të palëve “, angazhimi në plotësimin e pyetësorit për “letrën e kaltër” si dhe për planin strategjik të komunikimit.

### 3.3. Luftimi i korrupsionit

Zyra për Standarde Profesionale ka bërë shqyrtimin dhe hetimin e rasteve ndaj stafit të ATK-se për thyerje të rregullave të sjelljeve për ATK-ne, korrupsion dhe të gjitha llojet e shkeljeve të kodit të mirësjelljes, janë paraqitur gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) raste për hetim, ku prej tyre dy (2) raste nuk ka pasur bazë për hetim, pesëmbëdhjetë (15) raste janë të mbyllura dhe dy (2) raste janë në hetim.

NR. I RASTEVE TË PARAQITURA NË ZSP-Ë	NR. I RASTEVE PA BAZE PËR HETIM	NR. I RASTEVE TË MBYLLURA	NR. I RASTEVE NË HETIM ( GJYKATA, POLICI ETJ ).
19	2	15	2

Nga 15 raste të mbyllura për 7 zyrtar janë dhënë rekomandime për masë disiplinore, ndërsa rastet e tjera kanë qenë rekomandime menaxheriale.



## 4. Burimet Njerëzore

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në ATK-ë është 711, prej tyre 494 (69%) janë meshkuj dhe 217 (31%) femra. Sipas arsimimit nga numri i përgjithshëm i të punësuarve prej 711; me fakultet janë 532 (75%), me shkollë të lartë 15 (2%), me shkollë të mesme 160 (23%), dhe me shkollë fillore 4 (1%). Sipas përkatësisë etnike 692 (97.3%) janë Shqiptarë, Serbë janë 10 (1.4%), Turq janë 2 (0.3%) , te tjerë 7 (1%).

### TË PUNËSUARIT NË ATK-Ë SIPAS ARSIMIMIT

NR.	ARSIMIMI	GJITHSEJ	STRUKTURA
2	FAKULTET (SUPERIOR)	532	75%
3	SHKOLLA E LARTË	15	2%
4	SHKOLLA E MESME	160	23%
5	SHKOLLA FILLORE	4	1%
GJITHSEJ		711	100%

### TË PUNËSUARIT SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE

NR.	PËRKATËSIA ETNIKE	GJITHSEJ	STRUKTURA
1	SHQIPTARË	692	97.3%
2	TURQ	2	0.3%
3	SERBË	10	1.4%
4	TE TJERË	7	1.0%
TOTALI		711	100%

### 4.1.Trajnimet

Divizion i për Trajnim dhe Zhvillim me ndihmën dhe bashkëpunim e këshilltareve te DELOITTE-ESTAK gjatë viti 2010, ka realizuar dhe ofruar mbështetje teknike për trajnimet e brendshme dhe te jashtme,- (pranimi dhe shqyrtimin e kërkesave për organizim të trajnimit, përkujdesja për sigurim të sallës dhe pajisjeve teknike(projektor, laptop, flipchart,).njoftimi i pjesëmarrësve për kohën dhe vendin e trajnimit, përkujdesja për material të trajnimit para dhe gjatë trajnimit,monitorimi i mirëvajtjes së trajnimeve, sigurimi i biletave te udhëtimit, kontakte me ambasada te huaja) ofrimi i trajnimit bazë për zyrtaret e rinj, zhvillimi i anketës për Vlerësim të Nevojave të Trajnimit, hartimi dhe aprovimi i formularit për mbështetje nga zyra e trajnimeve, formulari për pajisje dhe formulari për vlerësim të trajnimit te afishuara ne SharePoint, aktivizimi i Rregullores së Trajnimeve, dizajnimi dhe krijimi i planit për rezervim te sallave te takimeve te ATK—ë dhe afishimi ne SharePoint, Themelimi i Komisionit për Trajnime, kontakte te vazhdueshme me organizatat trajnuese vendore dhe ndërkombëtare (OECD-Organizata për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim, CEF-Qendra e Eksellences Financiare, Silloveni, IKAP-Instituti i Kosovës për Administratë Publike, QSEZH-Qendra e Kosovës për Siguri, Edukim dhe Zhvillim , SHKACK-Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës, Instituti për Marrëdhënie me Publikun, MDA etj.



Nga ATK-ja janë organizuar 15 trajnime nga fushat e ndryshme të legjislacionit tatimor në të cilat kanë prezantuar 356 zyrtar, kemi marr pjesë në 12 trajnime tek organizata vendore trajnuese gjithsej 205 zyrtar, në OECD në 9 trajnime gjithsej 17 zyrtar, në CEF në 6 trajnime gjithsej 11 zyrtar dhe në 7 vizita studimore gjithsej 21 zyrtar.

Mbajtja e numrit të trajnimeve dhe pjesëmarrësve sipas institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

INSTITUCIONI	NUMRI I TRAJNIMEVE	NUMRI I PJESËMARRSVE
ATK-EUCTA	15	365
IKAP	3	9
FLSA	2	7
QKSEZH	1	2
IMP	2	19
SHKACK	1	24
MDA	1	3
LSE	1	138
IKM	1	3
OECD	9	17
CEF	6	11
VIZITA STUDIMORE	7	21
<b>TOTALI</b>	<b>49</b>	<b>619</b>

#### 4.2.Kodi i etikës dhe mirësjelljes

Administrata Tatimore ka nxjerr në Korrik të vitit 2007 Kodin e etikës dhe Mirësjelljes, i cili me vone është pasuruar edhe me Udhëzimin Administrativ Ruajtja e Integritetit të ATK-së, Nr. 17/2009 i nxjerr me 01.12.2009 si dhe Kodin e veshmbathjes dhe dukjen e punonjësve në punë për zyrtaret e ATK-së i nxjerr me 15.07.2010.

Kodi i etikës dhe mirësjelljes ka për qëllim ruajtjen dhe rritjen e besimit të ATK-së në raport me publikun, kryerja e detyrave të zyrtareve të ATK-së komfort ligjit si dhe pasqyrimi i standardeve të larta etike dhe morale ndaj publikut.



## 5. Buxheti dhe Prokurimi

Mjetet e parapara me buxhetin e vitit 2010, për të gjitha kategorit ekonomike janë flokuar në vlerë prej 6.6 mil. €. Nga mjetet e alokuara janë shpenzuar në vlerë prej 6.5 mil. € prej të cilave për paga janë shpenzuar 3.9 mil. € ose 99 %, për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 1.5 mil. € ose 96 %, për shpenzime komunale janë shpenzuar 169,094 € ose 97 %, ndërsa për shpenzime kapitale janë shpenzuar 845,735 € ose 92%.

Kategoria e shpenzimit	Buxheti 2010	Alokimi i mjeteve 2010	Shpenzimi i mjeteve 2010	Shpenzimi i mjeteve 2009	% e shpenzimeve	Krahasimi 2010/09
0	1	2	3	4	6=3/1	5=3/4
Pagat dhe mëditjet	3,976,098	3,976,098	3,947,480	3,490,507	99%	113%
Mallrat dhe Shërbimet	1,585,873	1,559,207	1,523,816	1,626,760	96%	94%
Shpenzimet Komunale	188,320	181,564	181,564	169,094	97%	107%
Shpenzimet Kapitale	924,377	924,377	845,735	1,105,766	92%	76.48%
<b>Total</b>	<b>6,674,667</b>	<b>6,674,667</b>	<b>6,498,595</b>	<b>6,392,127</b>	<b>97%</b>	<b>102%</b>

### Projektet kapitale të realizuara gjatë vitit 2010

Emri i Projektit	Të buxhetuara	Të alokuara	Të zotuar	Të shpenzuara	% (4/2)
0	1	2	3	4	5
Ndërtimi i objektit të ri në Regjionin e Prizrenit	111,404	111,404	111,403	111,403	100%
Arkat fiskale	189,026	189,026	188,987	188,987	95%
Upgrade-i i SIGTAS-it	303,395	303,395	303,395	278,803	92%
Meremetimi i objektit në Gjilan	20,000	20,000	20,000	16,735	84%
Zhvillimi i aplikacionit e-filling	105,000	105,000	105,000	105,000	100%
Arkiva elektronike	63,500	63,500	63,500	63,220	100%
Furnizimi me pajisje	34,100	34,100	34,100	33,634	100%
Softweri për vijimin në punë	50,000	50,000	50,000	-	-
Authentifikimi multi-faktorial	47,952	47,952	47,952	47,952	100%
<b>Totali</b>	<b>924,377</b>	<b>924,377</b>	<b>924,338</b>	<b>845,735</b>	<b>92%</b>

Departamenti i prokurimit gjatë vitit 2010 ka zhvilluar rreth 72 aktivitete të prokurimit, nga të cilat një pjesë e aktiviteteve të prokurimit janë realizuar, një pjesë e aktiviteteve gjendet në realizim dhe një pjesë e aktiviteteve është në realizim sipas porosive dhe nevojave të ATK-se. Disa aktivitete të prokurimit janë anuluar bazuar në dispozita ligjore të Ligjit të prokurimit publik dhe secili arsyetim për anulim është publikuar në shtypin ditor. Departamenti i Prokurimit ka bërë mbikëqyrjen e realizimit të aktiviteteve të prokurimit për vitin 2010 për kontratat që janë realizuar, kontratat që janë bartur dhe vazhduar nga viti 2009 në vitin 2010 si dhe ka zhvilluar edhe aktivitete të tjera të parapara me Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë.



## 6. Risite progresive gjate vitit 2010

### 6.1.Ndryshimet ligjore

Gjatë vitit 2010 është bere kompletimi i pakos legjislativë 2010 me aprovimin dhe hyrjen në fuqi te legjislacionit tatimor dhe akteve tjera mbështetëse:

EMRI I LIGJIT	NR.I LIGJIT	MIRATUAR NË KUVEND	HYRJA NË FUQI
LIGJI PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE	NR. 03/L-161	29.12.2009	01.01.2010
LIGJI PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE	NR. 03/L-162	29.12.2009	01.01.2010
LIGJI PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR	NR. 03/L-146	29.12.2009	01.07.2010
LIGJI PËR ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT	NR. 03/L-222	12.07.2010	18.08.2010

UDHËZIMET ADMINISTRATIVE	NR.I UDHËZIMIT	NËNSHKRUAR NGA MINISTRI I MEF-IT	HYRJA NË FUQI
UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-162, PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE	NR. 08 / 2010	30.07.2010	30.07.2010
UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-161, PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE	NR. 09 / 2010	30.07.2010	30.07.2010
UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.3/L-164 PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR	NR.10 / 2010	30.07.2010	30.07.2010
UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE	NR. 13/2010	19.11.2010	19.11.2010
UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE	NR. 14/2010	19.11.2010	19.11.2010
UDHËZIMI ADMINISTRATIV PËR ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT	NR. 15/2010	19.11.2010	19.11.2010

### 6.2.Numrat Fiskal dhe Arkat Fiskale

Pasqyra e lëshimit te numrave fiskal sipas regjioneve dhe bizneseve.

REGJIONI	DEKLARUESIT	TOTALI I NR.FISKAL	PERSONAT FIZIK	BIZNESET INDIVIDUALE	BIZNESET JURUDIKE	PRONARET E BIZ. JURIDIKE	DEKLARUESIT / NR.FISKAL
0	1	2	3	4	5	6	7=1/2
FERIZAJ	6,078	6,526	245	4,694	1,197	390	93%
GJAKOVË	3,336	3,632	327	2,319	837	149	92%
GJILAN	5,400	7,007	1,049	4,371	1,245	342	77%
MITROVICË	5,051	5,708	651	3,802	1,022	233	88%
NJTM	415	465	6	86	328	45	89%
PEJË	6,427	6,451	375	4,680	1,100	296	100%
PRISHTINË 1	10,945	13,444	1,239	6,910	4,037	1,258	81%
PRISHTINË 2	6,952	7,102	240	4,831	1,765	266	98%
PRIZREN	9,420	10,779	1,789	6,921	1,624	445	87%
<b>TOTALI:</b>	<b>54,024</b>	<b>61,114</b>	<b>5,921</b>	<b>38,614</b>	<b>13,155</b>	<b>3,424</b>	<b>88%</b>

Burimi: Teknologji Informativë.



Administrata Tatimore e Kosovës, që nga muaji Mars 2010, ka njoftuar për fillimin e instalimit vullnetar të Pajisjeve Elektronike Fiskale (PEF), ndërsa nga muaji Prill 2010, ka njoftuar se të gjithë tatimpaguesit që kanë pikat e shitjes me paratë gatshme, janë të obliguar të pajisen me Pajisje Elektronike Fiskale.

Kërkesa e përcaktuar me ligj për të regjistruar transaksionet, nëpërmjet të regjistruesve të Pajisjeve Elektronike Fiskale, dhe kërkesa për të lëshuar kuponin për mallrat dhe shërbimet që janë blerë, do të jetë në dobi të popullit të Kosovës, kjo përmirëson aftësinë e Administratës Tatimore, për tu siguruar që të gjithë tatimpaguesit i përmbushin obligimet e tyre tatimore dhe i raportojnë me saktësi të ardhurat e tyre. Kjo do të thotë konkurrencë e drejtë në vendin e tregut dhe ndihmë për mbrojtjen e bizneseve të ndershme, prej atyre personave, të cilët përpiqen të shesin mallrat, apo shërbime pa paguar obligimet tatimore që dalin nga këto shitje.

#### BIZNESET E PAJISURA ME ARKA FISKALE

REGJIONI	BIZNESET E PAJISURA ME PAJISJE ELEKTRONIKE FISKALE	NUMRI I PAJISJEVE ELEKTRONIKE FISKALE	STRUKTURA E PAJISJEVE ELEKTRONIKE FISKALE
0	1	2	3=1/Σ
FERIZAJ	306	366	5%
GJAKOVË	295	426	5%
GJILAN	792	951	13%
MITROVICË	821	909	13%
NJTM	174	927	3%
PEJË	883	1,045	14%
PRISHTINË 1	866	991	14%
PRISHTINË 2	358	410	6%
PRIZREN	1,167	1,356	18%
PA PËRCAKTUARA	665	935	11%
<b>TOTAL</b>	<b>6,327</b>	<b>8,316</b>	<b>100%</b>

### 6.3. Teknologjia Informative

Teknologjia informative përveç projekteve në vazhdimësi dhe projekteve të reja ka realizuar me sukses misionin e ofrimit të shërbimeve të Teknologjisë Informative për zyrtarët e ATK-se duke ju ofruar përkrahje dhe shërbime elementare në sistemin baze tatimor SIGTAS pastaj qasje në sistemin e përgjithshëm, e-mail adresë, internet dhe shërbime tjera të domosdoshme dhe të avancuara. Projektet e zhvilluar gjatë kësaj periudhe janë si në vijim:

- 1. Projekti i ripërtëritjes së SIGTAS-it-** nga Janari 2010 është vazhduar me përpjekjet për zhvillimin e moduleve baze si regjistrimi i tatimpaguesve, lëshimin i numrave fiskal, pastrimi i të dhënave jo korrekte në regjistra, procedura e kalkulimit për të gjitha llojet e tatimeve, vlerësimeve, dokumenteve, kontrolleve si dhe përgatitja e zhvillimi i pjesshëm i moduleve periferike të SIGTAS si moduli i kontrolleve, mbledhjes së detyrueshme dhe moduli i ankesave.
- 2. Sistemi i ndërlidhjes - Interfac-i me Bankën Qendrore të Kosovës**
- 3. Sistemi për gjenerimin e Deklaratave Elektronike-** Gjenerimi dhe publikimi i deklaratave elektronike



4. *Avancimi dhe pasurimi i portalit të brendshëm të ATK-se me raporte dhe vegla sipas kërkesave të menaxhmentit*- Ne portalin e brendshëm të TI-se janë ndërtuar me se 103 raportet në total së bashku me veglat e ndryshme të integruara në sistem.
5. *Projekti i deklarimit elektronik-ne proces të përfundimit të testimeve dhe kyçje në punë.*
6. *Projekti i arkivës elektronike*
7. *Projekti i menaxhimit të Pajisjeve Elektronike Fiskale-*
8. *Projekti i ndërlidhjes së sistemit të Informativë në mes të ATK-se dhe Doganave të Kosovës*
9. *Ndërtimi i sistemit sekondare në Pejë dhe gjithë rrjetin informativ të TI-se në ATK*
10. *Ndërtimi i faqes së re të internetit [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org)*

#### 6.4.Plani Strategjik 2010 - 2015

Ne vitin 2010, nga menaxhmenti me datën 30.06.2010, është aprovuar Planin Strategjik 2010 – 2015, që paraqet një dokument shumë të rëndësishëm për zhvillimin e ATK-se. Në kuadër të këtij plani janë të përfshira edhe strategjia e përmbushjes dhe strategjia e modernizimit të teknologjisë informative. Përmes këtij Planit Strategjik Administrata Tatimore ka përcaktuar objektivat që duhet të arrihen si dhe veprimet që duhet të ndërmerren, afatet kur duhet të përmbushen këto objektiva dhe veprime me bartësit dhe përgjegjësit e tyre.

Planin strategjik 2010 – 2015, përfshin modelin e përmbushjes me 12 strategji të cilat kanë të bëjnë me:

- Mishërimi me obligimet e përcaktuara përmes Statusit ( Kartës ) të tatimpaguesve;
- Sigurimi i integritetit të bazës së të dhënave;
- Puna me publikun për edukimin e vazhdueshëm rreth kryerjes së obligimeve tatimore;
- Përmirësimi i kapaciteteve teknik të stafit të edukimit të tatimpaguesve dhe shfrytëzimi i metodave të reja për ofrimin e informatave për publikun;
- Vendosija e proceseve që do të ndihmojnë parashtrimin dhe përpunimin me kohë të deklaratave dhe pagesave;
- Parandalimi dhe intervenimi i hershëm;
- Rritja e efektivitetit të programeve të kontrollit dhe analizës së rrezikut dhe identifikimin e mundësive, me fokus në ato çështje dhe kontrole që do të kenë ndikim më të madh në përmbushje dhe do të gjenerojnë shumë më të madhe të të hyrave;
- Ulja e mundësive për evazion dhe shmangie;
- Aktivitetet e i hershëm dhe efektive të mbledhjes;
- Teknologjia Informativë;
- Resurset Njerëzore;
- Akomodimi;

Gjithashtu, Planin Strategjik 2010 – 2015, përmban projeksionin e të hyrave sipas regjioneve dhe llojeve të tatimeve si dhe projeksionin e buxhetit, bazuar në Kornizën Afatmesme të shpenzimeve.

Pjesë përbërëse e planit strategjik janë edhe Indikatorët për matjen e performancës sipas departamenteve në veçanti dhe ATK-se në përgjithësi, nëpërmjet të cilëve do të matet performanca e institucionit.



## 6.5. Formimi i Njësive të reja

Ne vitin 2010 është rishikuar organogrami i ATK-se, me qëllim të riorganizimit dhe ngritjes së efikasitetit të disa departamenteve dhe krijimit të njësive të reja. Është formuar Drejtoria për Modernizim dhe Planifikim Strategjik, Drejtoria e Zyrës Ligjore dhe Ankesave dhe Drejtoria për Auditim dhe Standarde profesionale.

Ne kuadër të Drejtorisë për Modernizim dhe Planifikim Strategjik është duke u implementuar projekti i arkave fiskale, si dhe në bashkëpunim me Drejtorin për Teknologjinë Informativë është duke u punuar për modernizimin e proceseve biznesore dhe përdorimin me të madh të veglave të T.I.-se ( deklarimi elektronik, shkarkimi i deklaratave, arkiva elektronike ).

Po ashtu është formuar Njësia për Hetime Tatimore dhe Ekipi për Menaxhimin e Rrezikut, funksionalizimi i këtyre njësive pritet gjatë vitit 2011.

Zyra e Avokatit të tatimpagueseve është themeluar, si pozite e re në ATK-ë dhe ka filluar të funksionojë nga Janari 2010.

# ORGANIZIMI TERRITORIAL SIPAS ATK-së



[www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org)

Adresa: Këndi i rrugëve Bill Klinton & Dëshmorët e Kombit  
10000 Prishtinë, KOSOVË

Tel & Fax (+381 38) 200 250 17 & 200 250 07  
E-mail: [info@atk-ks.org](mailto:info@atk-ks.org)